Banka Populllore e Republikës së Maqedonisë
Drejtoria për Statistikë

Shkup, 31 maj 2024

Njoftim për shtyp

Lëvizjet më të rëndësishme në bilancin pagesor[1] në tremujorin e parë të vitit 2024

Në tremujorin e parë të vitit 2024, në transaksionet aktuale me jorezidentë është realizuar deficit prej 185 milionë eurove, si rezultat i deficitit në shkëmbimin e mallrave dhe te bilanci i të hyrave primare. Te transaksionet financiare me jorezidentë janë realizuar hyrje neto nga investimet direkte dhe dalje neto në bazë të valutave dhe kredive tregtare depozitare, investimeve të portofolit dhe kredive.

Komponentët bazë të bilancit të pagesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut

(në milionë euro)

	viti aktual	viti paraprak		ndryshimet tremujore		ndryshimet vjetore	
	T.1 2024	T.1 2023	T.4 2023	milionë euro	%	milionë euro	%
Llogaritë rrjedhëse	**-185.0**	**92.8**	**-111.7**	**-73.3**	65.6	**-277.8**	...*
Mallra	**-811.9**	**-601.0**	**-762.2**	**-49.7**	6.5	**-210.8**	35.1
Shërbime	**301.9**	**253.3**	**171.0**	**130.9**	76.6	**48.6**	19.2
Hyrje primare	**-193.2**	**-185.1**	**-186.3**	**-7.0**	3.7	**-8.2**	4.4
Hyrje sekondare	**518.2**	**625.6**	**665.7**	**-147.5**	-22.2	**-107.5**	-17.2
Llogaria kapitale	**0.0**	**0.2**	**-0.7**	**0.7**		**-0.2**	
Llogaria financiare	**-155.4**	**92.3**	**-91.7**	**-63.7**		**-247.7**	
Komponenta më të rëndësishëm:							
Investimet direkte	**-235.9**	**-143.3**	**-206.2**	**-29.7**		**-92.7**	
Krijimi neto i mjeteve	**223.2**	**215.9**	**-388.9**	**612.0**		**7.3**	
Kapital vetanak	**28.1**	**15.2**	**22.5**	**5.6**		**12.9**	
Riinvestim të fitimit	**4.8**	**5.5**	**4.3**	**0.5**		**-0.7**	
Instrumente të borxhit	**190.3**	**195.2**	**-415.7**	**606.0**		**-4.9**	
Krijimi neto i detyrimeve	**459.1**	**359.1**	**-182.7**	**641.7**		**99.9**	
Kapital vetanak	**98.9**	**49.8**	**49.0**	**49.9**		**49.1**	
Riinvestim të fitimit	**134.9**	**139.7**	**-102.2**	**237.1**		**-4.9**	
Instrumente të borxhit	**225.3**	**169.6**	**-129.4**	**354.7**		**55.7**	
Investime të portofolit	**76.2**	**-438.5**	**37.3**	**38.8**		**514.6**	
Valuta dhe depozita	**174.6**	**124.0**	**-99.0**	**273.6**		**50.6**	
Huamarrje	**23.6**	**163.7**	**-384.9**	**408.5**		**-140.1**	
Kredi tregtare	**98.3**	**115.3**	**-31.8**	**130.0**		**-17.0**	
Të drejtat special të tërheqjes	**-0.1**	**0.2**	**0.1**	**-0.1**		**-0.3**	
Rezerva valutore	**-291.9**	**266.7**	**592.8**	**-884.7**		**-558.6**	

...* Ndryshimi procentual është mbi 100

Shënim: Në llogarinë financiare shenja (-) shënon hyrjet-neto nga jasht. Te rezervat valutore shenja (+) shënon rritje, ndërsa shenja (-) shnënon uljen e mjeteve valutore. Në të dhënat e rezervave valutore janë përjashtuar ndryshimet e çmimeve dhe diferencave të kursit.

Burimi: BPRMV-ja.

[1] Bilanci i pagesave është një raport statistikor që sistematikisht i përmbledh të gjitha transaksionet ekonomike në Republikën e Maqedonisë së Veriut me vende të huaja për një periudhë të caktuar kohore, pra i përmbledh transaksionet aktuale, kapitale dhe financiare ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve.

Llogaria aktuale

Në tremujorin e parë të vitit 2024, nga aspekti i zhvillimeve te komponentët e llogarisë rrjedhëse, deficit është realizuar në shkëmbimin e mallrave (811,9 milionë euro) dhe te të hyrat primare (193,2 milionë euro), që i tejkaloi hyrjet neto të realizuara te hyrjet sekondare dhe te shkëmbimi i mallrave (518,2 dhe 301,9 milionë euro, përkatësisht).

Krahasuar me tremujorin e njejtë të vitit të kaluar, kur u arrit suficit në llogarinë aktuale prej 92,8 milionë euro, deficiti në llogarinë aktuale është rritur për 277,8 milionë euro, që kryesisht vjen nga rritja e deficitit të shkëmbimit të mallrave, si dhe nga suficiti më i ulët te hyrjet sekondare. Ndryshimi te shkëmbimi i mallrave tregon për një përmirësim, pra një suficit në rritje prej 48,6 milionë euro.





Burimi: BPRMV-ja

Llogaria financiare

Në tremujorin e parë të vitit 2024, te transaksionet financiare me jorezidentë janë realizuar hyrje neto prej 155,4 milionë euro. Hyrjet neto janë realizuar te investimet direkte (235,9 milionë euro), derisa daljet neto janë regjistruar te valutat dhe depozitat (174,6 milionë euro), kreditë tregtare (98,3 milionë euro), investimet e portofolit (76,2 milionë euro) dhe kreditë (23,6 milionë euro).

Hyrjet neto në bazë të investimeve direkte (235,9 milionë euro) janë rezultat i hyrjeve neto të realizuara te të gjitha komponentet, pra te fitimi i riinvestuar (130,1 milionë euro), kapitali vetanak (70,8 milionë euro) dhe te borxhi ndërkompanive (35,1 milionë euro). Për krahasim, në tremujorin e parë të vitit të kaluar, hyrjet neto nga investimet direkte shënojnë 143,3 milionë euro.

Në tremujorin e parë të vitit 2024, detyrimet në bazë të investimeve direkte[2] shënojnë rritje prej 459,1 milionë euro, si rezultat i rritjes neto të detyrimeve në bazë të borxhit ndërkompanive

[2] Shfaqen investimet direkte varësisht nëse transaksionet financiare krijojnë detyrim drejt ose kërkesë (mjete) nga jasht.

(225,3 milionë euro), fitimit të riinvestuar (134,9 milionë euro) dhe kapitalit vetanak (98,9 milionë euro).

Mjetet në bazë të investimeve direkte janë rritur për 223,2 milionë euro shkaku i rritjes së kërkesave në bazë të borxhit ndërkompanive (për 190,3 milionë euro) dhe kapitalit vetanak për (28,1 milionë euro) dhe fitimit të riinvestuar (për 4,8 milionë euro).

Në tremujorin e parë të vitit, detyrimet neto në bazë të investimeve të portofolit shënojnë rënie prej 76,2 milionë euro. Ndryshimi i tillë kryesisht vjen nga ulja e detyrimeve të letrave me vlerë të borxhit të emetuara më parë nga shteti dhe në një masë më të vogël nga riblerja e eurobondeve vendase nga rezidentët. Njëkohësisht, janë realizuar kërkesa të reduktuara nga investimet e rezidentëve në letrat me vlerë të huaj (10,1 milionë euro) dhe të borxhit (25,9 milionë euro).

Detyrimet neto në bazë të kredive janë ulur për 23,6 milionë euro, kryesisht si rezultat i daljeve neto te banka qendrore[3] (145,9 milionë euro), dhe më pak te sektori "institucione depozitare" (9,3 milionë euro) dhe te sektoret tjera[4] (2,2 milionë euro). Sektori "shteti" shënon rritje të detyrimeve (133,8 milionë euro).

Në tremujorin e parë të vitit, hyrjet neto nga investimet direkte (235,9 milionë euro), si dhe rezervat valutore mundësuan financimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe të daljeve neto te komponentat tjera të llogarisë financiare.





Burimi: BPRMV-ja.

[3] Aktivitete të Bankës Popullore të lidhura me udhëheqjen me rezervat valutore.
[4] Sektorët tjerë përfshijnë: institucione tjera financiare, ndërmarrje jofinanciare, amvisëri dhe institucione joprofitabile që ju shërbejnë amvisërive.

Informacione shoqëruese

Të dhënat e serive kohore: vjetore, tremujore dhe të dhëna mujore për bilancin e pagesave https://nbstat.nbrm.mk/pxweb/mk/

Sqarime metodologjike: https://www.nbrm.mk/platen_bilans-al.nspx

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave
http://www.nbrm.mk/kalendar_na_objavuvanje_na_podatoci-al.nspx

Bilanci pagesore tremujorë: 30 gusht 2024 (periudha referuese, deri më qershor 2024).

Për pytje gazetareske, ju lutemi të kontaktoni personat nga Kabineti i guvernatorit.

Për informacione më të detajuara lidhur me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02 3215 181 lokal 103 (ose 110/108).